

Qefsere Nishevc

Gazetare



Në foto: Qefsere Nishevc

Nga arkivi personal i Qefsere Nishevcit

Unë jam Qefsere Nishevc, jam nga Prishtina. Jam e lindur me 27 janar 1957, domethonë i takoj shekullit të kalumë. Si Muhaxherë jemi familja jonë, domethonë të parët e mi kanë jetu në Serbi pastaj janë shperngulë në fshatin Nishevc që është komuna e Prishtinës. E prej fshatit Nishevc janë shpërngulë në Ballovc ku unë jam lindur. Si gjashtë mujshe kam ardhë në Prishtinë, dhe kom jetu në Prishtinë, domethanë fëmijërinë tem e mbaj në mend këtu si prishtinase. Pastaj shkollën fillore e kom kry në “Naim Frashëri”, të mesmen, gjimnazin në “*Ivo Lola Ribar*”¹ dhe kam përfundu studimet për Gjuhë dhe Letërsi shqipe. Meniherë masi i kom përfundu studimet, në vitin 1982 unë jam punësu si gazetare në “Zërin e Rinisë”.

Shumë interesant ka qenë, motra ime e ka pa ni letër që ishte ni konkurs edhe unë thash “*Wow*, qiky është profesioni im, do të konkuroj”, edhe e kisha një farë besimi. Unë për veti e pata kry Gjuhë dhe Letërsi shqipe siç e përmenda edhe më herët, dhe kështu që nuk kisha përvojë për gazetari, por normalisht kam dashur librat, kam lexuar mjaft, fjalorin e kam pasë të pasur, por nuk mjafton për gazetarinë një gjë e tillë, edhe ka qenë ajo thënia, “Ani, gjuni gazetarët në ujë ashtu, dhe ata ashtu mësohen për të notuar”, e kjo ka qenë pak gjë e vështirë për ne si gazetarë. Mirëpo kolegët gjithmonë kanë qenë shumë të mirë, shumë mikpritës edhe shumë të gatshëm për me të ndihmu. Kështu që, jemi formu dalëngadalë si gazetarë, pastaj kemi marrë

¹ Tash shkolla “Sami Frashëri”

pjesë edhe në kurse, kanë ardhë njerëz nga Beogradi, kanë dhënë mësimë për shkrime të ndryshme, për llojet e shkrimeve të ndryshme, kështu që s'kemi pasur probleme pastaj.

S'pari më kujtohet temën kur ma patën dhanë ka qenë për mua interesant, ka qenë "Arsimi i mesëm i orientuar". Unë e dija që ekziston ky 'arsim i mesëm i orientuar', se ishin ato fazat e ndryshimit të arsimit, të sistemit të arsimit edhe fare nuk e kuptoja si është e mundshme që të ketë anomali të tilla dhe s'më hike në kry si gazetarë, thosha "E pse, e pse?", e ma vonë kur e bëra ni intervistë me ni psikolog Millien Kokaran, më kujtohet shumë mirë, ai e shpjegoi shumë bukur, ai e shpjegoi se ky ndryshim në sistemin e arsimit ishte dështim i plotë.

Kur kom hi herën e parë në punë ne kemi punu me ato makinat a e dini të shtypit që kanë qenë, s'kemi pasë kompjuter. Po ato kanë qenë me shtypë "Tap, tap", edhe unë s'kisha përvojë dhe e shtypja "Cak, cak", ni shkronjë aty, ni shkronjë aty, edhe njëni Arif, [mendohej] Arifi mbiemrin, Qerim Arifi më duket, ose...nejse. Ndoshta ajo s'është me rëndësi, mirëpo ishte shkrimtar. Dhe ai e zgjati krytë edhe, "Ha, a po të duhet patrulla e policisë me t'i gjetë shkronjat?", edhe tjetër gjë interesante kur kom punu në "Zeri", unë pata dëgju për shkrimtarë të ndryshëm edhe tani nuk i dijsa, i shifsha disa figura "Mirëdita, mirëdita", përshëndeteshim në lift e kështu, e tek ma vonë e merrja vesh "Ha, po ky qenka ky? Ky qenka ky shkrimtar" [qeshë]. E ma vonë e lidhsha personin me ftyrën, me personalitetin e tij, edhe ka qenë interesant me punu me intelektualë e me njerëz që për shembull me librat e tyre jemi rritë ose me poezitë e tyre.

Puna jonë ka qenë e lidhun me terren edhe me mbledhje, aktivitetet i kemi bo bashkë, serbë, shqiptarë krejt kemi marrë pjesë në ato mbledhje. Aty jemi formu, aty e kemi gjetë kolegë, aty kemi shkëmby mendime. Normal që për shembull, ni profesion mësohet prej ni personi që ka ma shumë përvojë, prej atyre që kanë ma shumë përvojë. Janë tregu të hapun me ne, me na tregu, "Bëne këtë, bëne këtë, ekziston ky problem, shko atje", edhe kështu që puna jonë nuk ka qenë e lidhur për zyre. Në zyre kemi shku, kemi shkru artikuj, kemi mbajtë ndonjëherë mbledhje, kur ka dalë "Zëri" për shembull, numri, e kemi komentu cili shkrim ka qenë më i mirë. Të parin në fillim ne kemi pasë bllokun, lapsin e kemi marrë shënime. Kjo ka qenë pak e lodhshme se ndonjëherë ka njerëz që flasin shumë bukur, e ti s'munesh me arritë me i marrë krejt. E tani domethonë, e kemi zhvillu ne gazetarët në atë kohë atë aftësinë që me shkrujt senet kryesore, shumë interesant se zhvillohet ajo, se me punën që bon zhvillohet.

Ma vonë, magnetofon kemi perdorë, ato të voglat, po mu më vinte vështirë me magnetofon, se me magnetofon shumë gjatë, e kështu i kisha dyat, kisha qef me i përdorë dyat, edhe shkrimin, se në shkrim e shkruaja për shembull fjalën çelës, ajo që më interesonte më shumë, e tani kur e dëgjoja krejt, më shumë kohë më merrte. Por, një gja që është dashur me bo është dashur me shkru mënjëherë, se ti s'munesh me pritë, për shembull me pritë se munesh me haru, e ke në kokë, e din se çka ka thanë personi, i ki shënimet, edhe kështu kemi shtypë, ka qenë ma vështirë. Tash kur e mendoj, kur kemi deshtë me bo prezantimin e ni personi, ose kur kemi dashtë me bo ni intervistë me ni person, u dashtë me shku me ni ven, në arkivë me pa çfarë personaliteti është, çka ka shkru, çka ka ba, edhe aty krejt m'i mbledhë ato shënime, me marrë shënime, me qenë të përgatitun kur e bojmë intervistën me dikun. Se kur e bon ti ni intervistë me ni person ti duhesh me ditë për jetën e tij, çfarë pune ka ba, sa ka punu, çfarë intervista, në

mënyrë që ti me pasë çka me pyet. Ti një punë nëse don me ba mirë duhet me shkru të vërtetën, ti prej tavolinës nuk mundesh me shkru tema të vërteta. Për shembull, kur don me shkru një temë, për shembull me nxënësit ke qef, unë domethanë e kisha këtë rubrikë, kisha qef me e ndi mendimin e nxënësve, nuk muj une me shkru prej tavolinës një koment për çka mendojnë nxënësit për një çështje të caktuar pa bisedu me ta. Kështu që duhet me shku në terren, me shku me vizitu shkollat, me pa çfarë probleme kanë. Për shembull një kohë nuk dihej a kemi gjimnaz matematikor a s'kemi, edhe duhet me shku atje me folë me drejtorin, me nxënësit, me pa në terren si është situata.

Një temë që nuk kam mujtë me shkru, ka qenë një temë shumë e dhimbshme një kohë, që ka qenë për këta ushtarët që na i binin të vrarë, edhe kur dilnim në rrugë edhe shihnim fotografi të njerëzve të ri, edhe një herë një redaktor më pat thanë për të shkruar për një, dhe unë e pata shkru. Po aty kërkohet me cenzurë me shkujt që ky ka qenë vrasës, por nuk dihej se ishte vrasës, ai u kthye i vramë, por, kinse ai ka vra dikënd, edhe unë nuk e shkrova këtë - që ka qenë vrasës, edhe ma vonë ai ma redaktoi më tha duhet ta shkruajsh, thash, "Jo se nuk e di", kur tha, "As unë nuk e di". E diqysh kisha qef me e ba najfarë komenti për qito gjana, po ishte temë që nuk prekej në atë kohë sepse ishte situata e tillë, domethanë në atë kohë ka pasë cenzurë, ndonihet kur të dhemb zemra për diçka ti ke qef me shkru, me folë me bërtitë me thanë, "Pse po ndodhin këto gjana?" po nuk ka mundësi ndonihet.

Edhe tani në atë kohë ka qenë një sistem shumë interesant, gjërat që ndodhën, ma interesante, ma të dhimbshme që kanë qenë, kanë qenë koha e helmimeve. E u nisëm për me shku në Podujevë me një grup që e kishim domethënë shoferin e ata reporterin e ata, edhe na patëm dëgju se atje katër nxanës me një klasë janë helmue, edhe nuk po dihet qysh.

<<< *Ambienti i punës në terren gjatë helmimeve në shkolla*>>>



"Për mos me u harrue: Helmimet mars e prill 1990"

Nga: profili personal i Ilaz Bylykbashit, postuar më 8 shtator 2022

Foto e shkrepur nga Ilaz Bylykbashi

Edhe na u nisëm, edhe tu shku ne rrugës po vinin kerret përballë nesh me një shpejtësi [*imiton zhurmën e makinave në shpejtësi*], edhe ky shoferi po thotë, "O shpresoj që nuk është ajo që po e mendoj..." edhe s'kishim nevojë me e komentu na thamë, "O shpresojë që nuk është ajo që po e mendojmë", por ishte. I kishin vu nxanësit nëpër kerre, nëpër kamione, edhe me shpejtësi shumë të madhe i qonin në spital. Po në spital ishin mbyllë dyert, kishin dalë studentët me tesha të bardha provonin me ju dhanë ndihmë, edhe ne u kthyem, edhe ne deshtëm me iu ndihmu, edhe ne thamë me marrë dikond prej atij kamionit me qitë në kerr tonë. E ne nuk mendonim se nëse ti e merr një person të kontaminum që është me helm, mundesh edhe ti me u kontaminu, e ne i morrëm. Megjithatë ne s'mendonim për vetën në atë moment edhe më kujtohet shumë mirë njena e ka pasë emrin Vjollca Gashi edhe ajo më tha [përshpëritë] "A mundesh me mi ngre flokët?" Ata domethanë kishin qasi dhimbje sa i ngrehshin flokët, po kjo s'kish mundësi, edhe më tha mua, "A mundesh me mi ngre flokët, me mi shkulë?" unë thash, "O Zot, ki mëshirë!" dyert e hapura rrugës, gratë, nanat tu kajtë, tu shiku çfarë ndodhte, ka qenë... qikjo ka qenë shumë e tmerrshme.

Në atë kohë, meqenëse ka qenë një periudhë e kohës kur unë isha... ishte sistemi komunist pastaj erdhi. Unë e mbërriva edhe pluralizmin politik, kur njerëzit u liruan më shumë me folë, këtu mund të vërejmë disa ndryshime, për shembull kur të shkonim në fabrika me i vetë punëtorët në atë kohën e komunizmit, "Si keni punët?" Ata thonin, "A është për gazeta?" - "Mirë

shumë i kemi”. Por, nuk ka qenë ajo liria për me folë, komunizmi këtë e ka pasë sjellë, dyfityrësinë, “Ti duhet me thanë qishtu, ti duhet mu bo qishtu, ti duhet qishtu me u paraqitë”. Kurse më vonë kur erdhi pluralizmi politik kur njëzit fillunë me u çliru prej sistemit që, “Ti duhet qishtu, duhet qishtu, duhet me thanë qishtu”, nisën me folë ma sinqerisht. Edhe kjo e bënë, shkrimin e bënë ma të bukur edhe gjithçka që është në jetë, edhe arti, edhe krejt është më e bukur kur është e vërteta aty.

Unë përvete nuk kisha qef, nuk e doja shumë politikën se s’kam qenë komuniste asnjëherë. S’kam pasë asnjëherë librezën e kuqe. Ka qenë shumë interesant, kur isha nxënëse kur më thoshin, “Eja të bëhesh...”, sepse aty për shembull nëse ishe po e zamë nxënëse e shkëlqyeshme, ose në fakultet nëse ishe studente e shkëlqyeshme, ata të ftonin që të bëheshe pjesëtare e Partisë Komuniste e Lidhjes Komuniste e kështu. Edhe unë asnjëherë nuk doja sepse m’dukej se fjalori i tyre ishte gjithmonë i kufizum, e kishin një këndvështrim të posaçëm për gjëra edhe mua s’më pëlqente kjo gjë edhe nuk dëshiroja. Kur konkurova në “Zëri” ata as nuk e dinin që unë asnjëherë nuk kam marrë pjesë në këto lidhjet komuniste, në këto organizata komuniste, s’kam qenë aktiviste, nuk e dinin. Nuk më pyetën edhe thjeshtë unë çova dokumentet që kishin kërkuar, fakultetin e pata kry me notë mesatare shumë të lartë edhe kaq ishte për mua.

Por njëher na ndodhi që shkuam në Beograd ne. Ishte dyzet vjetori i formimit të “Zërit tonë”, “Zërit të Rinisë”, edhe shkuam në Beograd në Dedinje për të nderuar varrin e Titos ose personalitetin e Titos më mirë me thanë, nejse personalitetin e tij. Po për të dërguar lule atje, si ishte atëherë sistemi, bëheshin gjëra të tilla, edhe kur shkova atje, në atë kohë Hashim Rexhepi nuk e njihni ndoshta ju, por ishte një person që merrej me politikë edhe i kishte rënë rasti që ai të ishte kryetar i Lidhjes së Rinisë së Jugosllavisë sepse në atë kohë zgjidheshin kryetarë prej vendeve prej, për shembull, e dini Jugosllavia ka qenë e përbërë prej gjashtë republikave dhe dy krahinave, që me radhë prej secilës krahinë ose republikë zgjedhej kryetari i cili do të përfaqësonte popullin e vet. Neve atë vit e kishim shqiptarë, kështu që ne vizituam Dedinjën, vizituam vendin ku është lindur Tito, edhe kështu. Edhe na ra me bisedu, kur i thash unë atij, “Unë s’jam komuniste”, ai tha, “Si është e mundur, ti s’je komuniste? Ti punon në Zërin e Rinisë që është organ i Lidhjes Komuniste, është organ i Lidhjes së Rinisë Socialiste”, tha, “S’është e mundshme që ti s’je”. I thash, “Jo, nuk jam as me zemër, po as librezën s’e kom marrë”. “Pse s’e ke marrë?” I tregova, thash, “Unë s’kam interesim për atë librezë”, thash, “Ata disa aktivistë tu tregu që janë aktivistë, m’kanë propozu por unë nuk e morra.” Edhe nuk e kisha kurrë. E tani ka qenë interesant se veç unë edhe njëfarë Nysret Metarapi, ka qenë foto-reporter, i ndjerë është tash, kemi qenë kështu, edhe unë e ai filisnim ndonjëherë kështu, [përshpëritë] “A ja ne s’jemi komunistë, komunizmi s’është në rregull...” [qeshë].

Edhe kur erdh puna që ndryshoi sistemi, kur Ibrahim Rugova shkoi në Amerikë, e kur u kthyen njerëzit, e kur u kthyen gazetarët u përshëndesnin, “Zoti e bekoftë Kosovën”, në kuptimin, me këtë dëshironin të thoshin se ne s’jemi më komunistë. Edhe njerëzit filluen ti hedhnin ato librezat e kuqe në tokë sepse edhe kjo Lidhja Komuniste ishte një nye me Serbinë, se i binte thua se jemi njejtë me ta. Kështu që u shkëputëm nga ata, dhe i hedhnin ato librezat e kuqe, edhe une e Nysret Metarapi thoshim, “Ah, të ju themi këtyre, ju ka ra diçka, ju ka ra diçka n’tokë”, [qeshë].

Edhe unë nuk kam punu tërë jetën si gazetare, kam punu dymbdhjetë vjet si gazetare, pastaj kam punu me UNMIK-un si përkthyes, pastaj në fund të fundit, sepse tash jam e pensionuar unë, kam punuar si mësimdhënëse e gjuhës dhe letërsisë shqipe me nxënës.

Krejt njerëzit në atë kohë kanë thanë se gazetaria është një punë që nuk t'len me jetu gjatë, unë e mohoj këtë se nuk kam qef me pranë, po ashtu ka qenë, ashtu thuhej dhe ka qenë një punë që e kanë konsideru si një punë me shumë stres. Po për shembull, nuk ka qenë si punët e tjera që i kam ba ma vonë, domethanë që e kemi orarin e caktum edhe ne jemi argëtu shpesh-herë në terren. Kemi ba shaka të ndryshme, kemi qeshë shumë, edhe e kemi rrespektu njëri-tjetrit, kemi qenë një grup që e kemi dashtë njëri-tjetrit, e që ende kemi dashuri për njëri-tjetrit, për shembull kur e kujtoj Valentina Sarçinin, sa here e shoh, ne përqaftimi, çmallemi, duhemi, kemi pasë raporte të mira me njëri-tjetrit. Është pak si...i ngjanë pak jetës shkollë, a e ke pa qysh është njëfarë dashurie mes njëri-tjetrit. Ashtu është...

Çka kam mësu shumë për arsimin, kam mësu që plan-programi është dhe duhet të zbatohet por, është me rëndësi personi. Për shembull, nxënësi është një person nuk mundësh me marrë ti [*imiton zhurmën e maqinave*] si mekanike... gjë mekanike, është person ka probleme sigurisht. Mund t'ketë probleme familjare, pastaj janë problemet e moshës, mund të kenë probleme të ndryshme të moshës. Ti duhet me i kuptu si njerëz me i ofru me dashuri, aq sa mundësh se për shembull, një person që e ki afër ti s'mundësh me i dhanë atij ku me ditë çka por një obligim që e kemi është me i dhanë respekt, pranueshmëri, e dashuri. Që nuk kushtojnë po mund të jenë shumë të vlefshme.

Kjo më ka ndihmu shumë pasi kam lexu shumë për nxënësit dhe për raportet e nxanësve me arsimtarë, edhe këto veti kam pasë qef me i pasë dhe shumë mirë jam nda me nxënësit. Kur jam pensionu e ashtu më kanë mungu, e i kam përqaftu, disa prej tyre ende më shkruajnë dhe kam raporte shumë të mira me ta.